



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA  
GJYKATA THEMELORE PRISHTINE

Numri i lëndës: 2022:081070  
Datë: 26.02.2025  
Numri i dokumentit: 06909245

**P.nr.58/23**

**NË EMËR TË POPULLIT**

**GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË/Departamenti i Përgjithshëm**, Gjyqtarja e vetme gjykuese Edita Çanta, me Bashkëpunëtorin Profesional Lavdim Mehmeti, në çështjen penale ndaj të pandehurit G. K., për shkak të veprës penale “Posedimi i paautorizuar i narkotikëve, substancave psikotrope ose analoge” nga neni 269 paragrafi 2 të KPRK-së, i akuzuar sipas aktakuzës se Prokurorisë Themelore në Prishtinë/Departamenti i Përgjithshëm, me shenjë PP/II.nr.1375/22, të datës 20.04.2022, pas mbajtjes së shqyrtimit fillestar, i hapur për publikun, me datë 31.01.2025, në të cilin shqyrtim ishin të pranishëm Prokurorja e shtetit Arta Cukaj dhe i pandehuri G. K., në bazë të nenit 365 të KPPK-së, në të njëjtën ditë mori dhe publikisht shpalli, këtë:

**A K T G J Y K I M**

**I pandehuri** G. K., nga ati S. dhe e ema F., e gjinise V., i lindur me date // ne Gj., me vendbanim ne rr. Xh. M., objekti N. 1, permbi furrën D., përballë autolarjes Z., kati /, nr.// komuna e F. K., me numer telefoni 044///, i gjendjes se mesme ekonomike, i martuar, baba i nje femije, me numer personal 1//, ka te kryer fakultetin e arteve- dega aktrim, punon freelancer, si regjisor dhe skenarist, shqiptar, shtetas i Republikes se Kosovës.

**ËSHTË FAJTOR**

Sepse:

Pa autorizim ka poseduar substanca narkotike, ashtu që me datë 13.10.2021, rreth orës 18:35 min, në rrugën “Sylejman Vuçitërna” në Lagjen Emshir, në Prishtinë, ashtu që gjatë patrullimit të njësiteve policore të Stacionit policor në Jugu në Prishtinë, është ndaluar vetura VW me targa //, të cilën ishte duke e drejtuar i pandehuri G. K., ku gjatë kontrollit të automjetit të tij është gjetur një sasi e dyshuar e substancës narkotike e cila pas ekzaminimit nga Agjencia për Forenzikë e Kosovës ka rezultuar të jetë e llojit Kanabis (Marihuanë) me peshë prej 0.35 gram.

-me këtë ka kryer veprën penale Posedimi i paautorizuar i narkotikëve, substancave psikotrope ose analoge nga neni 269 paragrafi 2 të KPRK-së.

Andaj, gjyqtarja e vetme gjykuese, në bazë të nenit të lartcekur dhe neneve 4, 7, 17, 21, 38, 43, 69, 70 të KPRK-së, si dhe nenit 365 të KPPK-së, të njëjtin e:

**E GJYKON**

**-DËNIM ME GJOBË** në shumë prej **300 (treqind) euro**, të cilin dënim duhet ta paguajë në afat prej pesëmbëdhjetë(15) ditëve nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

Në rast se dështon ta paguajë gjobën, atëherë konform neni 43 par.3 të KPRK-së, gjykata do të zëvendësojë dënimin me gjobë në dënim me burgim duke i llogaritur 20.00 euro gjobë në një ditë burgim.

-Obligohet i pandehuri që në emër të shpenzimeve të procedurës penale të paguajë shumën aq sa do të bëhet sipas llogaritjes përfundimtare nga arka e gjykatës, në emër të paushallit gjyqësor shumën prej tridhjetë (30) euro, në emër të kompensimit të viktimave shumën prej njëzet (20) euro të gjitha këto në afat prej 15 ditëve, pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi nën kërcënimin e përmbarrimit me dhunë.

**-Konfiskohet:** substanca narkotike e llojit Marihuanë (kanabisë) me peshë prej 0.35 gram, dhe urdhërohet shkatërrimi pasi aktgjykimi të marrë formën e prerë.

### **A r s y e t i m**

Prokuroria Themelore në Prishtinë–Departamenti i Përgjithshëm, pranë kësaj gjykate, ka ngritur aktakuzën nën shenjën PP/II.nr.1375/22, të datës 20.04.2022, me të cilën ka akuzuar G. K. për veprën penale “Posedimi i paautorizuar i narkotikëve, substancave psikotrope ose analoge” nga neni 269 paragrafi 2 të KPRK-së.

Gjykata, në përputhje me autorizimet ligjore që i atribuohen, ka caktuar dhe mbajtur shqyrtimin fillestar në prani të Prokurores së Shtetit Arta Cukaj dhe të pandehurit G. K..

Gjatë shqyrtimit fillestar të datës 31.01.2025, ku është lexuar aktakuza nga ana e prokurorit të shtetit dhe pas leximit të aktakuzës, i pandehuri G. K., është deklaruar fajtor për veprën penale që akuzohet, duke shtuar se “Ndihem fajtor, jam penduar për veprën penale, premtoj gjykatës që nuk do të përsëris veprën penale, e lus gjykatën që të më shqiptoj një dënim me gjobë sa më të ulët”.

Prokurorja e shtetit, në lidhje me pranimin e fajësisë nga ana e të pandehurit, ka deklaruar: “Pajtohem me pranimin e fajësisë konform dispozites 242 të KPPRK-së, pasi që i njëjti pranim gjen përputhje edhe me shkresat e lëndës, dhe është bërë pa presion”.

Gjykata pas vërtetimit se janë përmbushur kërkesat nga neni 242 par. 1, nën – par. 1.1, 1.2, dhe 1.3 të KPPRK-së, përkatësisht pas vlerësimit se i pandehuri e ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimit të fajësisë, se ky pranim është bërë në baza vullnetare dhe se mbështetet në faktet dhe provat që përmban aktakuza, po ashtu pas vërtetimit se aktakuza nuk përmban asnjë shkelje të qartë ligjore ose gabime faktike të paraparë me nenin 242 par. 1, dhe 2 të KPPRK-së, ka marrë aktvendim me të cilin ka pranuar pranimin e fajësisë nga i pandehuri lidhur me veprën penale e cila i vihet në barrë.

Pas pranimit të fajësisë dhe konstatimit të përmbushjes së kushteve në referim të nenit 242 par. 1, nën – par. 1.1, 1.2, dhe 1.3, të KPPRK-së, gjykata ka vlerësuar se nuk është e nevojshme vërtetimi i ndonjë fakti relevant për shqiptimin e dënimit dhe për këtë arsye ka vazhduar me shqiptimin e dënimit.

Duke u bazuar në këto që u cekën më lartë, gjyqtarja ka vendosur që të pandehurin t'a shpall fajtor për kryerjen e veprës penale, ngase në veprimet e të njëjtit i përmbajnë të gjitha tiparet e kësaj vepre penale dhe se i njëjti është penalisht përgjegjës.

Duke u bazuar në nenin 69 dhe 70 të KPRK-së, me rastin e shqiptimit të dënimit ndaj të pandehurit, gjykata i ka marrë për bazë disa rrethana që ndikojnë në llojin dhe lartësinë e dënimit. Si rrethana lehtësuese për të pandehurin, gjykata e ka marrë pranimin e fajësisë nga ana e të pandehurit; se është penduar për kryerjen e kësaj vepre penale, i premtun gjykatës se në të ardhmen nuk do të kryej vepra të tilla e as të tjera penale, bashkëpunimin e të njëjtit me organet e drejtësisë. Ndërsa gjyqtarja e çështjes, për rastin konkret, rrethanë rënduese nuk ka gjetur.

Sipas bindjes së gjyqtarës, dënimi me gjobë, duke i marrë për bazë rrethanat e përmendura më lartë, është dënim i drejtë, në harmoni me peshën e veprës penale dhe shkallën e përgjegjësisë së të pandehurit.

Gjyqtarja e çështjes, gjithashtu ka konstatuar se me këtë dënim mund të arrihet edhe qëllimi i dënimit, nga neni 38 i KPRK-së, i cili konsiston në parandalimin e të pandehurit nga kryerja e veprave penale në të ardhmen dhe të bëjë rehabilitimin e tij; të parandalojë personat e tjerë nga kryerja e veprave penale dhe të shpreh gjykimin shoqëror për veprën penale, ngritjen e moralit dhe forcimin e detyrimit për respektimin e ligjit.

Vendimi për kompensimin e shpenzimeve të procedurës penale dhe të paushallit gjyqësor është marrë në bazë të nenit 450 par.2 pika 2.1 dhe 2.6 të KPPK-së.

Vendimi lidhur me kompensimin e viktimave të krimit u mor në bazë Ligjit nr.05/L-036.

Duke u bazuar në këto që u cekën më lartë, është vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

**GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË**  
**Departamenti i përgjithshëm-Penal**  
**P.nr.58/23, datë 24.2.2025**

**Gjyqtarja,**  
**Edita Çanta**

**UDHËZIMI JURIDIK:**

Kundër këtij aktgjykimi ankesë mund të paraqesin personat e autorizuar brenda tridhjetë (30) ditëve, nga dita e dorëzimit të këtij aktgjykimit. Ankesa bëhet përmes kësaj Gjykate, për Gjykatën e Apelit në Prishtinë.